

**VENDIM**  
**Nr. 777, datë 12.12.2022**

**PËR NJË SHITESË NË VENDIMIN NR. 167, DATË 18.3.2022, TË KËSHILLIT TË**  
**MINISTRAVE, “PËR PËRDORIMIN E FONDIT TË RINDËRTIMIT, PËR**  
**FINANCIMIN E RINDËRTIMIT TË BANESAVE INDIVIDUALE NË BASHKITË**  
**DURRËS, VORË, KAMZË DHE RROGOZHINË”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 13, shkronja “b”, nënndarja “i”, dhe 36, të aktit normativ nr. 9, datë 16.12.2019, të Këshillit të Ministrave, “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”, miratuar me ligjin nr. 97/2019, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të nenit 7, të ligjit nr. 115/2021, “Për buxhetin e vitit 2022”, të ndryshuar, me propozimin e Zëvendëskryeministrit dhe ministër i Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Pas pikës 2, të vendimit nr. 167, datë 18.3.2021, të Këshillit të Ministrave, shtohet pika 2/1, me këtë përmbajtje:

“2/1. Përdorimin e fondit të rindërtimit, miratuar për vitin 2022, në masën 183 228 700 (njëqind e tetëdhjetë e tre milionë e dyqind e njëzet e tetë mijë e shtatëqind) lekë, për financimin e rindërtimit të banesave individuale në bashkitë Vorë dhe Kamzë, sipas detajimit të mëposhtëm:

a) Bashkisë Vorë i transferohet fondi, në masën 147 788 700 (njëqind e dyzet e shtatë milionë e shtatëqind e tetëdhjetë e tetë mijë e shtatëqind) lekë, në formën e transfertës së pakushtëzuar;

b) Bashkisë Kamzë i transferohet fondi, në masën 35 440 000 (tridhjetë e pesë milionë e katërqind e dyzet mijë) lekë, në formën e transfertës së pakushtëzuar.”.

2. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe bashkitë Vorë e Kamzë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**ZËVENDËSKRYEMINISTËR**  
**Belinda Balluku**